



KRYETARI I KOMUNËS  
01-Nr-~~11~~-14767  
ME DATE 30.03.2018

### SHPALLJE PUBLIKE

#### Për angazhimin e punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta. (Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve, Nr. 04/L-077 neni 615 i këtij Ligji, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 12 alineja 4, si dhe bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim si dhe Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta kërkon angazhimin e punëtorëve për kryerjen e punëve për nevojat e këtyre Drejtive.

**I. Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim kërkon dy (2) Zyrtarë/e profesional për planifikim-për Sektorin e Planifikimit të Drejtorisë  
Kohëzgjatja e marrëveshjes për shërbime te veçanta gjashtë (6) muaj  
Paga: E negociar  
Kualifikimi:-Ing i dipl. i Ndërtimtarisë-Arkitekturës(1)**

##### Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Mbledhjen e të dhënavë për profil komunal të Planeve Zhvillimore si dhe Përgatitjen e profileve sektoriale për to.
- Mbledhja e të dhënavë për nevoja të drejtorisë nga drejtorit tjera komunale
- Krijimi i dosjeve të planeve zhvillimore dhe raportimi pas çdo takimi.
- Punimi dhe leximi në Programin e Gis-it te PZhK, PZhU dhe PRrU
- Punimi dhe përgatitja e kushteve ndërtimore dhe njoftimeve publike.
- Punimi dhe përgatitja e Lejeve të Ndërtimit
- Punimi dhe përgatitja e Pëlqimeve për Ndarje të Parcelave, etj.
- Si dhe punë tjera me kërkesë të shefit dhe drejtorit

**Kualifikimi:-Bachelor i Ndërtimtarisë-Arkitekturës(1)  
Detyrat dhe përgjegjësítë:**

- Arkivimi i lëndëve të punuara nga sektori i planifikimit
- Përgatitjen e ftesave për takime dhe diskutime publike
- Punimi dhe përgatitja e Lejeve të rrënimit dhe Lejeve të Ndërtimit
- Dalja në teren për nevoja të drejtorisë
- Punimi dhe përgatitja e Vërtetimeve Urbanistike dhe Pëlqimeve në parim.
- Punon në komisione vlerësimi të objekteve dhe pranime teknike
- Si dhe punë tjera me kërkesë të shefit dhe drejtorit

**II. Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë dy (2) pozita:  
Një zyrtar/e për menaxhimin e mbeturinave**

**Kohëzgjatja e marrëveshjes për shërbime te veçanta gjashtë (6) muaj  
Paga: E negociuar**

**Kualifikimi:-Bachellor i biologjisë drejtimi ekologji dhe mbrojtje e mjedisit.  
Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen detyrat rreth mbarëvajtjes së punimeve në menaxhimin e mbeturinave
- Përkujdeset për aplikimin dhe zbatimin e kritereve mjedisore-ekologjike sipas ligjeve në fuqi.
- Përkujdeset për dhënien e kontributit të mbrojtjes ekologjike sipas standardeve të aplikueshme të kësaj fushë veprimitarie.
- Përpilon raportet e rregullta dhe periodike për punët dhe aktivitetet e realizuara.
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së eprorit.

**Një zyrtar/e për punë juridike - Administrative**

**Kualifikimi: Bachellor i fakultetit Juridik**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Mbaqjen e protokolit të drejtorisë
- Evidencimin dhe kompletimin e dosjeve të drejtorisë
- Përpilon përgjigjjeve dhe bënë raporte për palët që shtrojnë kërkesa
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së eprorit

**Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkon:**

- Të jete person me integritet te larte personal dhe moral;
- Aftësi të mira komunikimi ;
- Njohuri të mira të punës;

**Mënyra e aplikimit:**

**Kandidatet e interesuar duhet te paraqesin një biografi profesionalë (CV), certifikatën qe ndaj tij-saj nuk janë duke u zhvilluar hetimet,kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.**

**Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.**

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën (Negocimin) nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata te cilët nuk hyjnë ne përzgjedhjen e listës së ngushtë nuk do te kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të janë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë (Negocimi), duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen. Kërkesat e pakomplétuara do të refuzohen.

**Komuna e Suharekës ofron mundësi te barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.**

